

KËRKESË
Nr. 2300, datë 12.7.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“GE-CO” SH.P.K

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“GE-CO” SH.P.K

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIM
Nr. 4993, datë 24.5.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 000090-5, datë 10.1.2019, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit “GE-CO” sh.p.k., protokolluar me nr. 442 prot., datë 23.1.2019,

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën ii/b, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 000090-5, datë 10.1.2019, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit “GE-CO” sh.p.k., në vlerën 500 000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.